



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **HISTORI**

Lënda: HISTORIA E QYTETËRIMIT PERËNDIMOR (Shek. XVI – XVIII)

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Asoc. dr. Ermal BAZE
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 3 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Bazë
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Historia e qytetërimit perëndimor (shek. XVI – XVIII) studion zhvillimet politike, social – ekonomike, fetare e kulturore në Europë dhe në SHBA për një periudhë kohore tre shekujsh (shekulli XVI, XVIII, XVIII) në kufijtë kronologjikë relativë ose periudhën historike midis viteve 1500 – 1789 në bazë të përcaktimit të kufijve kronologjikë absolutë. Kjo epokë historike e emërtuar ndryshe si koha e hershme moderne ndahet në dy periudha kryesore: periudha e parë (fillon nga fundi i shekullit XV dhe fillimi i shekullit XVI dhe zgjat deri në gjysmën e parë të shekullit XVII) trajton Rilindjen e zhvilluar Europiane dhe Revolucionin shkencor, Reformacionin Protestant dhe Kundërreformacionin, zbulimet e mëdha gjeografike, si dhe zhvillimet politike e konfliktet fetare në mbretëritë në mbretëritë e shtetet më të rëndësishme evropiane. Periudha e e dytë, e cila njihet ndryshe si koha e absolutizmit ose e Regjimit të Vjetër (fillon nga mesi i shekullit XVII deri në vitet `80 të shekullit XVIII) trajton jo vetëm vendosjen e absolutizmit në Europë dhe konsolidimin e shteteve kryesore evropiane, por merr në shqyrtim edhe një sërë procesesh të rëndësishme historike me karakter social – ekonomik, politik e kulturor, si: Revolucioni Agrar dhe fillesat e Revolucionit të Parë Industrial, Iluminizmi, triumfi i parlamentarizmit dhe vendosja e monarkisë kushtetuese në Britaninë e Madhe dhe Revolucioni Amerikan.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Objekti i studimit të historisë së qytetërimit perëndimor në vitet 1500 - 1789. Kufijtë kronologjikë dhe periodizimi i historisë së qytetërimit perëndimor. Rëndësia e kësaj epoqe në historinë e njerëzimit.
2. Rilindja e zhvilluar evropiane përgjatë shekullit XVI.
3. Reformacioni Protestant dhe përhapja e tij në Europë. Lindja e Kishës Anglikane.
4. Reformacioni Katolik (Reformimi dhe riorganizimi i Katolicizmit).
5. Zbulimet e mëdha gjeografike (fundi i shekullit XV – fillimi i shekullit XVIII). Pasojat social – ekonomike dhe kulturore të zbulimeve gjeografike.
6. Ekspansioni kolonial evropian (shek. XVI – XVIII). Modelet e kolonizimit dhe tregtia e skllëvërve.
7. Zhvillimet politike në Europë (shekulli XVI – mesi i shekullit XVII).
8. Konfliktet fetaro – politike në Europë (mesi i shekullit XVI – gjysma e parë e shekullit XVII). Lufta fetare në territoret gjermane dhe nënshkrimi i Paqes së Augsburgut (1555). Lufta civile dhe fetare në Mbretërinë Franceze (1562 – 1598). Origjina, zhvillimi dhe rrjedhojat e Luftës 30 – Vjeçare (1618 – 1648).
9. Ekonomia dhe shoqëria evropiane në shekujt XVI - XVIII.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



10. Revolucioni shkencor (origjina dhe rrjedhojat e tij) (shekujt XVI – XVII). Revolucioni Agrar dhe fillimet e Revolucionit të Parë Industrial.
11. Epoka e Iluminizmit.
12. Vendosja e Absolutizmit në Europë (Forcimi i mbretërive kryesore europiane gjatë mesit të shekujve XVII – XVIII). Absolutizmi i Luigjit XIV. Absolutizmi në vendet e tjera të Europës. Absolutizmi i Iluminuar dhe reformat e sovranëve të iluminuar.
13. Lindja e Monarkisë Kushtetuese në Angli (Dinastia Stuart dhe konflikti mbret parlament, vendosja e protektoratit, restaurimi i Stuartëve dhe Revolucioni i Lavdishëm i vitit 1688). Krijimi i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe.
14. Luftërat e shekullit XVIII në Europë (Lufta për Trashëgiminë e Fronit Spanjoll 1701 – 1714. Lufta për Trashëgiminë e Fronit Austriak 1740 – 1748. Lufta 7 – Vjeçare 1756 – 1763).
15. Revolucioni Amerikan 1776 - 1783..

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursitose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Robert Roswell Palmer & Joel Colton, *A History of the Modern World to 1815*, seventh edition, (USA: McGRAW – Hill, Inc., 1992), përkthyer si manual nga Eris Grabovari dhe redaktuar nga E. Baze.
2. E. Baze, *Cikël leksionesh - Historia e qytetërimit perëndimor 1500 – 1789*, Tiranë, 2016
3. A. Pinari & Ll. Filo, *Historia e Europës dhe SHBA* (koha e hershme moderne 1500 – 1815), Tiranë: Ideart, 2007.
4. H. Shabanaj & F. Gjevori, *Historia Moderne: Europa në shekujt XVI – XVIII*, Tiranë: ALBAS, 2015.

Literatura plotësuese:

1. R. Gurakuqi, *Historia e Kohës së Re (2): Qytetërimi Perëndimor 1775 – 1871*, Shkodër: PHOENIX, 2001.
2. P. Nathanaili. *Historia e Botës Moderne*, Tiranë: ILAR, 2007.
3. F. Braudel, *Gramatikë e Qytetërimeve*, Tiranë: SHLK, 2005.
4. S. Rızaj, *Historia e Përgjithshme (1453 – 1783)*, Prishtinë: Rilindja, 1985.
5. *The New Cambridge Modern History* (volume I – VII), 1493 – 1763, Cambridge: Cambridge University Press, 2008.
6. Kolana e shtëpisë botuese Dituria: P. Milza, *Historia e Italisë*, Tiranë: Dituria, 2012. G. Duby, *Historia e Francës*, Tiranë: Dituria 2012. F. De Garcia & J. Gonzalez, *Historia e Spanjës*, Tiranë: 2012. G. Potesta & G. Vian, *Historia e Krishterimit*, Tiranë: Dituria, 2012. Th. Maissen, *Historia e Zvicrës*, Tiranë: 2013. J. Anisimov, *Historia e Ruisë*, Tiranë: Dituria, 2014. Ph. Chassaigne, *Historia e Anglisë*, Tiranë: Dituria 2015. A. Niederstätter, *Historia e Austrisë*, Tiranë: Dituria, 2015.
7. *Martin Luther – Reformatori*, botim i parë, Oxford: Oxford University Press, 1883.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



8. Martin Luther & Jean Calvin, *Mbi autoritetin shekullar dhe mbi qeverisjen civile*, Tiranë: ISP & DITA, 2000.